



Nr. Regj. 32184/2012

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË**, gjyqtaria Azra Cakolli me pjesëmarrjen e sekretares juridike Shemsije Lumi, duke vendosur në procedurën për kundërvajtje kundër të pandehurit Feti(Lazam)Mehdiu, nga Matiqani Komuna e Prishtinës, për kundërvajtje nga neni 5, 6 par 1.3 dhe neni 9 ndëshkuar me nenin 17 paragrafi 1.3 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë personat Zyrtarë, Nr. 04/L-050, në bazë të nenit 73, 74, 195, 199 dhe nenit 198 par 1 pika 8 të Ligjit mbi Kundërvajtjet(LK) GZ KSAK 23/79, më datë 15.11.2013 morri këtë:

### AKTVE N D I M

**PEZULLOHET** procedura kundërvajtëse kundër **Feti(Lazam)Mehdiu**, i lindur më 20.01.1944 në fshatin Zajazë, Komuna e Kerqovës, tani me vendbanim në rrugën "Isa Kastratit", pn, në Matiqan, Këshilltar Komunal në Prishtinë, i martuar baba i katër fëmijëve, ka kryer fakultetin Filozofikë, i gjendjes së mesme ekonomike, konform nenit 198 par 1 pika 8 pasi që nuk ka prova se ka kryer kundërvajtjen.

Shpenzime të procedurës nuk ka pas.

Nga një kopje e këtij aktvendimi ti dërgohet të pandehurit dhe ushtruesit të kërkesës.

### A r s y e t i m

**Agjencia Kundër Korrupsionit në Prishtinë**, i parashtrori kësaj gjykate kërkesën Nr. 01-2502/2012 me datë 07.08.2012 për fillimin e procedurës për kundërvajtje ndaj të pandehurit, për kundërvajtje nga neni 5, 6 par 1.3 dhe neni 9 ndëshkuar me nenin 17 paragrafi 1.3 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë personat Zyrtarë, me të cilën kërkesë i vihet në barrë se në Agjencinë Kundër Korrupsionit nuk e ka dorëzuar formularin mbi deklarin e pasurisë sipas kërkesës së Agjencisë.

Më datë 22.10.2012 gjyqtaria ka marr aktvendim me të cilin Feti Mediu, është shpallur fajtor dhe i është shqiptuar dënimi me gjobë në shumë prej 450 €. Kundër këtij aktvendimi kanë ushtruar ankesë i pandehuri Feti Mediu si dhe Agjencia Kundër Korrupsionit. Gjykata e Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë me Aktvendimin GJL nr. 1279/12 të datës 13.11.2012 ka abroguar Aktvendimin e shkallës së parë dhe lënda është kthyer gjykatës së shkallës së parë në plotësim të procedurës dhe rivendosje. Duke vepruar sipas vërejtjeve të Gjykatës së lartë, gjyqtaria mori në pyetje përsëri të pandehurin Feti Mediun i cili deklaroi se në lidhje mos deklarimin e pasurisë në kërkesë të Agjencionit, është lajmëruar në Agjenci dhe se në atë kohë zyrtari kompetent ka qenë në pushim vjetorë dhe për këtë arsye nuk ka pas mundësi të informohet për çka bëhet fjalë dhe se deri më datën 22.08.2012 nuk ka mundur me kontaktuar me zyrtarin e Agjencisë, në ç rast dhe ka bërë plotësimin e formularit për deklarim të pasurisë të cilin deklarim e ka bërë me vonesë duke pretenduar se pa fajin e tij ka ardhur deri te vonesa. Ka prezantuar Vërtetimin nr. 03/3643/12 të datës 22.08.2012 për deklarim të pasurisë.

Është ftuar pika kontaktuese Nexhmije Krasniqi, e cila deklaroi se Feti Mediu është njoftuar si të gjithë Këshilltarët të tjerë dhe gjykatës ia ka prezantuar Listën për Dorëzimin e Formularëve të datës 22.03.2012, ku shihet nënshkrimi që ka pranuar formularin në fjalë, deklaratën e ka dhënë në prezencën e Fetiut dhe i njëjti e ka parë nënshkrimin e tij në Listë.

